

VENDIM
Nr. 197, datë 5.4.2006

***PËR HAPJEN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
REPUBLIKËN E MALIT TË ZI***

(Ndryshuar me VKM nr. 767, datë 16.11.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Hapjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi.*
2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e vitit 2006, t’i shtohet fondi prej 17 966 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha